



SYLLABUS I LËNDËS “ANALIZA FINANCIARE”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Analiza Financiare
Programi:	Menaxhment Ndërkombëtar
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II- semestri IV
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	E Henë: 10:00 - 11:30 Ligjerata: Ushtrime: 11:00-12:30; 12:30-14:00
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr.Venet Shala
Të dhënat kontaktuese:	E-mail: venet.shala@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Në këtë lëndë trajtohen konceptet që lidhen me analizën financiare të firmave. Në këtë lëndë përfshihen analiza e pasqyrave financiare, treguesit financiar, leva operative dhe financiare, analiza e vlerës në kohë të parasë, analizën e riskut dhe kthimit, vlerësimin e instrumenteve financiare, analizën e metodave të financimit, afatin e shlyerjes, IRR, NPV, dhe analizën e raporteve financiare. Kjo lëndë u mundëson studentëve të zhvillojnë aftësinë për përdorimin e teknikave bashkëkohore për analizimin dhe vlerësimin e raporteve financiare, rrezikut financiar dhe kthimin nga investimet në projekte rentabile dhe fitimprurëse.</p>
Qëllimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë njohuri themelore lidhur me analizat financiare të cilat janë më se të nevojshme dhe shërbejnë si informacion bazë për menaxhmentin e kompanisë me rastin e marrjes së vendimeve të rëndësishme. Kështu, që kjo lëndë trajtonë problemet lidhur me vlerën kohore të parasë, do të shqyrtojë mundësitë dhe format e financimit të aktivitetit ekonomik të firmave dhe mundësitë e investimit në instrumente financiare, si dhe analizën e pasqyrave financiare dhe te raporteve financiare.</p>
Rezultatet e të nxënit:	<p>Pas përfundimit të kursit studenti do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të shpjegojë konceptet themelore që lidhen me analizën financiare, vlerën në kohë të parasë, riskun dhe kthimin, raportet financiare;• Ti kuptoj dhe lexoj pasqyrat financiare• Te kuptoj treguesit financiar dhe te bejë interpretimin e tyre• Të vlerësojë rrezikun në investime;• Të analizojë përdorimin efikas të instrumenteve financiare;• Të zbatojë modelet e vlerësimit të letrave me vlerë në tregjet e parasë, tregjet e kapitalit dhe tregjet derivative;• Të identifikojë dhe analizojë burimet e financimit të biznesit dhe faktorët influencues në përpjestimin relative ndërmjet burimeve të financimit.



Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	3	3	9
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	2	3	6
Kollokfiume, seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	3	2	6
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	7	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	1	4	4
Projektet, prezantimet, etj	2	15	30
Totali			125 orë (5 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive, diskutime, punime seminarike, etj.		
Metodologjia e vlerësimit:	Vlerësimi bëhet me anë të testit, kurse nota përfundimtare përbëhet prej katër komponentëve: - Pjesëmarrja dhe aktiviteti në orë: 0-10 pikë - Kolokuiumi Parë: 0 - 45 pikë - Punimi seminarik: 0 - 10 pikë - Kolokuiumi i dytë: 0- 45 pikë • Provimi: 0 - 100 pikë		
Literatura			



Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> Financial Statements: A step by step guide to understanding and creating financial report: Thomas R. Ittelson, 2022 Analiza e Pasqyrave Financiare: Shefket Jakupi, Bedri Statovci, Prishtinë, 2021
Literatura shitesë:	<ul style="list-style-type: none"> Financial Statement Analysis: A Practitioner's Guide: 5th edition Martin Fridson, Fernando Alvarez, 2022 Analiza Financiare me Auditim: Nazmi Iballi, Prishtinë, 2019

Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në Analizën Financiare/ Syllabusi	Hyrje në lëndë/ prezantimi i syllabusit
<i>Java e dytë:</i>	Analizë e vlerës në kohë e parasë Vlera aktuale (PV) Vlera e ardhshme (FV)	Ushtrime me detyra
<i>Java e tretë:</i>	Metodat e analizës financiare	Ushtrime grupore ne klasë
<i>Java e katërt:</i>	Pasqyrat financiare: Analiza horizontale dhe vertikale	Ushtrime praktike me detyra
<i>Java e pestë:</i>	Lidhja midis pasqyrave financiare	Ushtrime me detyra praktike
<i>Java e gjashtë:</i>	Raportet financiare: Raportet e likuiditetit, Raportet e frytshmërisë	Detyra me zgjidhje praktike: Kalkulimi i raporteve
<i>Java e shtatë:</i>	Analiza Du Pont	Ushtrime me detyra: Kalkulimi i raporteve te anlizes DuPont
<i>Java e tetë:</i>	Kollokfiumi 1 / Vlerësimi intermediar	Kollokfiumi 1
<i>Java e nëntë:</i>	Leva afariste dhe leva financiare	Detyra praktike me zgjidhje
<i>Java e dhjetë:</i>	Pasqyra e rrjedhës së parasë: aktivitetet operative, investive, financuese	Ushtrime me detyra: Përpilimi i pasqyrës se rrjedhës së parasë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Analizë e instrumenteve financiare Instrumentet e tregut të parasë Instrumentet e tregut të kapitalit	Detyra praktike: Analiza e modeleve
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i aksioneve Modeli matematikor i vlerësimit të aksionit	Ushtrime për vlerësimin e modelit te aksioneve te rregullta dhe preferuara
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Analizë e produktivitetit: Produktiviteti i rrjedhës, Produktiviteti në maturim	Kalkulimi dhe analizimi i produktivitetit
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Buxhetimi i kapitalit– metodat e buxhetimit. Metoda e shlyerjes Vlera aktuale neto. Norma e brendshme e fitimit	Ushtrime me detyra: Metodat e buxhetimit te kapitalit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kollokfiumi 2/ Vlerësimi intermediar	Prezantimet e punimeve të studentëve
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		



-
- Studentët duhet të jenë të ndërgjegjshëm dhe t'i respektojë rregullat e institucionit
 - Duhet të respektojnë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jenë të vëmendshëm në orët e mësimit
 - Duhet ta kenë ID kartelën me veti, kure testimi nuk mund ti nënshtrohet pa pas me veti ID kartelën
 - Gjatë hartimit të punimeve, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi
 - Në orët e testimit nuk lejohet përdorimi i telefonave mobil